



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.3.2022, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit përgjegjës të projektligjit “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022-2026”.
2. Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi të projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën cm/res (2013) 66”.

#### **Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Enslemvera Zake, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Edmond Spaho, Benet Beci, Erion Braçe, Anila Denaj, Bujar Leskaj, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Antoneta Dhima dhe Dashamir Shehi.

#### **Mungojnë:**

Blerina Gjylameti, Alfred Rushaj, Jorida Tabaku, Agron Shehaj dhe Shpresa Marnoj.

#### **Të ftuar:**

Elsa Dhuli – Drejtore e Përgjithshme e INSTAT-it

Maldi Dema – Drejtor i Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore në INSTAT

Helda Mitre – Drejtore e IT-së dhe Grumbullimit të Dhënave në INSTAT

Elona Sevrani – Drejtore e Prodhimit Statistikor në INSTAT

Meri Kumbe – Zëvendësministre e Kulturës

Anila Muka - Drejtore e Drejtorisë së Integritimit në Ministrinë e Kulturës

Gentian Opre - Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vilma Causholli - Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Analizës Buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

## HAPET MBLEDHJA

**Eduard Shalsi** – Mirëmëngjesi!

Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Konfirmojmë kuorumin. Në rregull.

Mund të thërrasim medien.

Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sot në rendin e ditës, sikundër jeni në dijëni, kemi dy çështje: shqyrtimin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, e projektligjit “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022-2026”, dhe pika e dytë është shqyrtimin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën cm/res (2013) 66”.

Për pikën e parë kemi dy relatore, zonjën Denaj dhe zonjën Koti, ndërkohë që për pikën e dytë kemi relator zotin Sinaj.

Të ftuar për çështjen e parë kemi përfaqësuesit e INSTAT-it, drejtoreshën e Përgjithshme, zonjën Dhuli së bashku me zotin Dema, drejtor i Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore, zonjën Mitra, drejtore e IT-së dhe Grumbullimit, dhe zonjën Sevrani, drejtore e Prodhimit Statistikor në INSTAT, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision!

Do të doja t’ia jepja fjalën fillimisht zonjës Dhuli, pastaj të vijojmë me relatorët për të kaluar te faza e pyetjeve, përgjigjeve dhe diskutimeve, nëse do të ketë, para se ta hedhim në votim.

Zonja Dhuli, fjala për ju.

**Elsa Dhuli** – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar deputetë,

Projektprogrami i statistikave zyrtare për periudhën 2022-2026 është dokumenti i parë i këtij lloji, i cili i paraqitet Kuvendit në formën e një projektligji, sipas kërkesave të neneve 7 dhe 8 të ligjit nr. 17 të vitit 2018 “Për statistikat zyrtare”.

Programi është dokumenti bazë, që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe

mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar zbatimin e parimeve statistikore të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të ligjit “Për statistikat zyrtare”, parime të cilat janë në përputhje me ato të parashikuara në Kodin e Praktikës së Statistikave Europiane.

Gjithashtu, programi shërben për orientimin e INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore, si: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, drejt cilësisë së prodhimit statistikor, sipas standardeve të parashikuara nga *acquis communautaire*.

Përveç zbatimit të kërkesave të ligjit “Për statistikat zyrtare”, projektprogrami siguron edhe përmbushjen e rekomandimeve të BE-së për kryerjen e veprimtarisë statistikore në vend, sipas një dokumenti, i cili duhet të jetë i hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së BE-së nr. 223, të vitit 2009 “Për statistikat europiane”.

Duke pasur parasysh definicionin e Sistemit Kombëtar Statistikor, ky program përcakton kompozimin e këtij sistemi statistikor në Shqipëri, gjithashtu ai mundëson legjitimitetin e institucioneve prodhuese për akses në të dhënat administrative, si dhe detyrimin e institucioneve furnizuese për dhënien e këtij aksesi.

Si asnjëherë më parë, gjatë periudhës 2019-2021 Sistemi Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-i në veçanti u përballën me situata përtej kufijve natyrorë si pasojë e tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë globale COVID – 19, sfida të cilat e vendosën INSTAT-in para përgjegjësisë dhe masave për menaxhimin e situatave të krijuara dhe qasjes pranë përdoruesve në kohë reale.

Një regjistër i detajuar rrisi rreziqin është hartuar dhe është në zbatim për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë prodhuese dhe minimizimin e dëmeve në raste të përballjes së situatave të ngjashme.

Ndryshe nga programet e mëparshme, ky dokument parashikon objektivat strategjikë-zhvillimore në nivel sistemi për periudhën 5-vjeçare, duke përcaktuar edhe modalitetet për arritjen e këtyre objektivave dhe indikatorët e performancës.

Objektivat lidhen me:

- Zhvillimin e Sistemit Kombëtar Statistikor për të përmbushur plotësisht *acquis communautaire* lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht procesin e integritetit europian.
- Plotësimin e kërkesave të përdoruesve për statistikat zyrtare.
- Prodhimin e statistikave zyrtare në një nivel të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranura europiane dhe ndërkombëtare.

- Rritjen e numrit të institucioneve, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor.
- Modernizimin e proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe eficiencën në kosto të statistikave zyrtare.

Ndërkohë, treguesit e performancës pasqyrojnë performancën e këtij institucioni, të cilat lidhen me numrin e të dhënave të shfaqura në *database*-t statistikore të Eurostat-it në Shqipëri, i cili ka shkuar nga 3,1 milionë nga 2,9 milionë që ka qenë një vit më parë.

Numrin e të dhënave të shfaqura në *database*-n e INSTAT-it, i cili është rritur me 15%, ka shkuar në 145 mijë, të dhëna nga 125 mijë që ishte një vit më parë.

Numrin e vizitave në faqen e internetit të institucionit, i cili ka shkuar në afro 5,3 milionë vizita nga 3,3 milionë që ishte një vit më parë.

Numrin e takimeve me përdoruesit, të cilët kanë qenë 5 nga 2, që ishte një vit më parë.

Numrin e treguesve në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, ku INSTAT-i prodhon 56 indikatorë në kuadër të kësaj strategjie.

Niveli i kënaqësisë së përdoruesve të statistikave të prodhuara nga INSTAT-i është rritur me 0,3% krahasuar me një vit më parë.

Numri i referimeve ndaj produkteve të Sistemit Kombëtar Statistikor në medie, gazetat ditore kryesore apo në televizione ka pasur një rritje të konsiderueshme.

Rritja e besimit të publikut në Sistemin Kombëtar Statistikor dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur, do të rrisë performancën e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe këtij institucioni në veçanti.

Ndërkohë, Kuvendi i Shqipërisë do të ketë një panoramë më konkrete dhe më të qartë të ecurisë dhe performancës së Sistemit Kombëtar Statistikor nëpërmjet shqyrtimit të raporteve periodike që paraqiten nga Instituti i Statistikave.

Projektprogrami përcakton edhe aktivitetet statistikore kryesore dhe mbështetëse që do të kryhen në kuadër të censit të popullsisë dhe banesave, i cili parashikohet në tetor të këtij viti.

Pas miratimit të këtij ligji, Kuvendit të Shqipërisë do t'i paraqitet për miratim edhe plani vjetor 2022 për zbatim, ku përfshihet gjithashtu data e fillimit të censit dhe pyetësori që do të intervistohet gjatë periudhës së terrenit për censin.

Censi i bujqësisë gjithashtu zë një pjesë të veçantë në këtë program.

Përmbajtja e projektprogramit 2022-2026 shtrihet në 10 kapituj, të cilët mbështeten në informacione më të detajuara në anekset përkatëse bashkëngjitur këtij dokumenti. Dy kapitujt e

parë i kushtohen informacionit për sfidat e programit të ri 2022-2026, si dhe qasjes krahasimore me programin e mëparshëm. Sipas informacionit të dhënë, programi parashikon përmirësimin e metodave për mbledhjen e të dhënave, metodologjive prodhuese, reduktimin e afateve kohore të prodhimit për të përmirësuar koherencën e indikatorëve, si dhe rritjen e transmetimeve në Eurostat.

Për herë të parë përdoruesit dhe publiku i gjerë mund të konsultojnë këta kapituj, ku janë paraqitur në formë vizuale ndryshimet progresive për secilën fushë statistikore.

Kapitulli i III-të fokusohet në atë çfarë kërkohet konkretisht nga ligji “Për statistikat zyrtare”, objektivat zhvillimorë të Sistemit Kombëtar Statistikor, masat për arritjen e tyre dhe indikatorët e monitorimit të performancës. Për shkak të natyrës strategjike të dokumentit, INSTAT-i e ka përshtatur këtë kapitull pjesërisht në përputhje me sistemin e menaxhimit të informacionit për planifikimin e integruar IPSIS.

Kapitujt IV-VI paraqesin veprimtarinë statistikore në vend, të ndara sipas fushave statistikore të përcaktuara në shtojcën nr. 1 të ligjit “Për statistikat zyrtare”. Listohen institucionet e ngarkuara për prodhimin e statistikave zyrtare dhe kuadri rregullator mbi të cilin mbështetet veprimtaria statistikore në vend.

Kapitujt në vijim përmbajnë informacione për sistemin e menaxhimit të cilësisë, parashikimet e burimeve financiare dhe njerëzore të INSTAT-it, të nevojshme për zbatimin e këtij programi.

Ndërkohë, kapitujt e fundit kanë të bëjnë me analizën SWOT, menaxhimin e risqeve dhe problemeve të pritshme, të cilat kërkojnë marrjen e masave përkatëse parandaluese për të siguruar suksesin e zbatimit të këtij programi.

Draftimi i programit u krye nëpërmjet angazhimit të veçantë të të gjithë aktorëve të përfshirë në Sistemin Kombëtar Statistikor, me mbështetjen e qeverisë shqiptare, institucioneve, përdoruesve dhe partnerëve ndërkombëtare, të cilët kanë mundur jo vetëm dhënien e inputeve të nevojshme për të përcaktuar prioritetet e fushave statistikore për 5 vjetët e ardhshëm, por edhe për të garantuar sigurimin e burimeve të nevojshme për kryerjen me sukses të aktiviteteve statistikore.

Në drejtim të prodhimit statistikor, në programin e statistikave zyrtare 2022-2026 janë planifikuar të realizohen 118 aktivitete statistikore, të ndara sipas fushave të mbulimit dhe

kompetencës së agjencive statistikore, ku 107 aktivitete do të kryhen nga Instituti i Statistikave, 9 aktivitete nga Banka e Shqipërisë dhe 2 aktivitete nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Sipas fushave statistikore në statistikat sociale dhe demografike, që përfshijnë fushat që lidhen me statistikat e popullsisë, tregut të punës dhe pagave, arsimit, shëndetësisë, të ardhurave dhe shpenzimeve të konsumit, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe krimit, kulturës dhe përdorimit të kohës do të realizohen 37 aktivitete statistikore.

Në statistikat ekonomike, ku përfshihen fushat, si: statistikat makro-ekonomike, statistikat financiare të qeverisë, fiskale dhe sektori publik, si dhe statistikat e ndërmarrjeve do të realizohen 20 aktivitete.

Në statistikat sektoriale, të cilat përfshijnë një sërë fushash heterogjene, si: statistikat e bujqësisë, peshkimit dhe pyjeve, statistikat e energjisë, transportit dhe turizmit, statistikat për tregtinë e jashtme, bilancin e pagesave, të çmimeve, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit.

Do të realizohen 46 aktivitete edhe në statistikat e mjedisit dhe *multidomain*, të cilat përfshijnë: statistikat e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme, statistikat e ujit, të biodiversitetit do të realizohen 15 aktivitete.

Për sa i përket temës së informacionit statistikor gjeohapësinor, INSTAT-i me anë të sistemit të hartografisë krijon, mirëmban dhe zhvillon informacionin gjeohapësinor për qëllime statistikore, për realizimin efektiv të të cilave Sistemi Kombëtar Statistikor do të fokusohet në: përmirësimin e metodologjisë statistikore, në 70 aktivitete, nga 49 të përmirësuara gjatë programit të kaluar; modernizimin e metodave të mbledhjes së të dhënave në 31 aktivitete, nga 24 të përmirësuara në programin e kaluar; reduktimin e afateve kohore të përpunimit dhe publikimit të të dhënave në 32 aktivitete, nga 19 të përmirësuar në programin e kaluar; rritjen e të dhënave të transmetuara në Eurostat për 110 aktivitete, nga 49 të transmetuara gjatë 5-vjeçarit të kaluar.

Në drejtim të menaxhimit institucional, Instituti i Statistikave do të përqendrohet në sigurimin e vazhdimësisë së aktiviteteve statistikore, duke ruajtur vlerat e statistikave zyrtare që mund të riskohen nga situatat e paparashikuara. Do të përdorim instrumente komunikimi dhe motivimi të punonjësit, në mënyrë që të rritet dhe forcohet ndërgjegjja për një kulturë ndryshe zhvillim dhe inovacion.

Statistika në shkolla është një tjetër risi në këtë drejtim.

Sistemi Kombëtar Statistikor do të hartojë politika dhe strategji efikase duke vendosur standarde, duke aplikuar rregullore, udhëzime, manuale dhe stimuj të tjerë formalë, që të orientojnë institucionet publike drejt arritjes së objektivave të programit, ku synohet përafrimi me udhëzimet dhe manualët e BE-së dhe Eurostat-it në kuadër të kapitullit XVIII-të për integrimin europian.

Nga ana organizative, Instituti i Statistikave parashikon forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor nëpërmjet rritjes së rolit të Këshillit të Statistikave, Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare, grupit të botës akademike të statistikave zyrtare dhe grupeve të përdoruesve në aspektet e planifikimit, monitorimit dhe raportimit të ecurisë së programit.

INSTAT-i, si koordinator i sistemit, nëpërmjet zbatimit të strategjisë së komunikimit, do të punojë për t'iu përafruar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigoroze parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare.

Në kuadër të censeve apo aktiviteteve të tjera statistikore, INSTAT-i parashikon zhvillimin e takimeve me grupet e përdoruesve apo module të veçanta trajnimi, dedikuar kryesisht përfaqësuesve të medias, për të rritur shkallën e kuptueshmërisë dhe interpretimit të statistikave zyrtare në vend.

Duke ju falënderuar paraprakisht për mbështetjen tuaj, mbetemi në shpresë të miratimit të këtij projektligji!

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit, zonja Dhuli!

Jam shumë i bindur që kolegët do të kenë pyetje.

Në fakt, po jetojmë në një periudhë ku data dhe të dhënat po konsiderohen pasuri e jashtëzakonshme. Ne jemi dëshmitarë shpeshherë të vendimeve qëllimmira, të cilat nuk japin rezultatet e duhura për shkak se janë të bazuara në informacion të gabuar. Nuk mund të ketë një vendimmarrje të mirinformuar pa të dhëna të sakta.

Unë personalisht qoftë në pozicionin e anëtarit të kabinetit qeveritar, qoftë në atë të deputetit shpeshherë kam ndeshur probleme të mëdha dhe jam përballur me mëdyshje vendimmarrjesh, të cilat kanë ardhur si rezultat edhe i të dhënave jo të sakta, ndaj e çmojmë shumë rolin e Institutit të Statistikave, që tashmë nga një vendim të mëparshëm i Kuvendit, është i pavarur nga qeveria dhe varet direkt nga parlamenti.



Disa ditë më parë ne përjetuam një ngjarje që uroj të jetë e fundit, kur punonjës të OSHEE-së u shfaqën pranë një zonje të moshuar duke i prerë dritat për shkak se nuk kishte paguar. Ajo që në fakt prisja ishte ndërtimi i një sistemi të tillë, që kur inspektorët apo ata që mbikëqyrin terrenin, të mos shkojnë pranë familjeve të tilla, por t'i pengojë sistemi para se të marrin një hap të tillë. Solla një shembull të thjeshtë për të kuptuar se sa i rëndësishëm është informacioni tek ata, të cilët realisht teksa jepnin shpjegime, të kuptonin që ishte një vendimmarrje e gabuar.

Nga ana tjetër, ju përmendët sektorin e bujqësisë, përgjatë këtyre viteve nga ku kam nxjerrë një të dhënë, 6 deklarata titullarësh të Ministrisë së Bujqësisë që kanë deklaruar një numër fermerësh krejtësisht të ndryshëm nga njëri-tjetri, që fillojnë që nga 35 mijë deri në 320 mijë, statistika të bujqësisë, të cilat kanë qenë objekt debati në fakt edhe disa muaj para, kur miratonim buxhetin dhe paketën fiskale për të ditur se çfarë impakti do të kishte.

Dëgjojmë shpesh debate publike, dhe është më se normale të kemi pikëpamje të kundërta për mënyrën se si u qasemi taksave, njëri krah apo krahu tjetër, por, nga ana tjetër, nuk duhet të kemi debat kur vjen puna për disa të dhëna, ku sa më i saktë të jetë informacioni, aq edhe më i panevojshëm është debati.

“S’kanë bukë të hanë shqiptarët” – thotë një protestues, ndërkohë që janë pikërisht të dhënat ato që duhet të hedhin dritë dhe të jenë të pakontestueshme.

Unë e çmoj realisht rolin e INSTAT-it dhe ne jemi dëshmitarë të një përmirësimi cilësor që ka pasur ky institucion në vitet e fundit.

Do të doja t’ua jepja fjalën kolegëve për pyetje. Zonja Resulaj ka ngritur dorën e para.

Ndjesë! Fjalën e kanë relatoret fillimisht, zonja Denaj.

**Anila Denaj**- Faleminderit!

Së pari, ju përgëzoj për përgatitjen e programit statistikor 2022-2026 dhe zgjerimin e fushave, në veçanti, përmirësimin e informacionit të raportimit të të dhënave në fushën për mbrojtjen sociale dhe të dhënat në drejtësinë penale.

Në aspektin procedural ky komision e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës, bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Qëllimi i këtij projektligji është paracaktimi i objektivave zhvillimore të sistemit kombëtar statistikor, aktiviteteve statistikore, afateve të zbatimit përgjegjësi të institucioneve prodhuese statistikore dhe institucioneve furnizuese me të dhënat për periudhën 2022-2026.

Programi i statistikave zyrtare përbëhet nga 9 kapituj. Nuk do të ndalem në detaje, sepse ju i sqaruar të gjitha, por unë jam ndalur në fjalën time në disa elemente të rëndësishme, si: paraqitja e informacionit lidhur me aktivitetet përmirësuese në aspektin e metodologjisë, metodave të mbledhjes së të dhënave, afateve kohore dhe transmetimit të tyre në EUROSTAT, objektivat zhvillimore, masave për arritjen e tyre dhe indikatorët e monitorimit të performancës, institucionet e ngarkuara për prodhimin e statistikave dhe numrin e aktiviteteve që kryejnë ato për ta miratuar këtë proces edhe më vonë, paraqitja e informacionit për sistemin e menaxhimit të cilësisë për të garantuar prodhimin e statistikave cilësore në vend, sepse cilësia është fokusi i këtij programi, analizën për menaxhimin e risqeve dhe problemeve të pritshme të cilat kërkojnë marrjen e masave përkatëse për të siguruar suksesin në zbatimin e këtij programi, që, sigurisht, vjen edhe nga analiza e gjithë programit të mëparshëm.

Në raport me rezultatet e pritshme dua të theksoj atë që i takon sistemit të mbrojtjeve sociale, që u përmend pak më parë me rastin që solli në vëmendje kryetari, sot ne po flasim për të dhëna të cilat në raport me mbrojtjen sociale duhet të jenë më të agreguara sipas grupeve dhe nevojave përkatëse të tyre nëpërmjet mekanizmave që siguron INSTAT-i për të zgjeruar numrin e institucioneve furnizuese nga ato ekzistuese, rritjen e bashkëpunimit në mes institucioneve për përmirësimin e metodave të transmetimit të të dhënave, për të siguruar transparencën periodike të këtyre të dhënave dhe shtimin e treguesve të rinj të mbrojtjes sociale nga burimet ekzistuese të të dhënave administrative dhe burimeve të reja.

Sigurisht jo më pak i rëndësishëm është përmirësimi të dhënave në sistemin e drejtësisë penale nëpërmjet mekanizmave që siguron INSTAT-i, duke konsistuar në prodhimin e treguesve cilësor dhe të krahasueshëm në fushën e drejtësisë dhe krimin, prodhimin e treguesve cilësorë të krahasueshëm për të zgjeruar këtë informacion edhe në interes të BE-së, informacionin dhe harmonizimin e definicioneve dhe rregullave në zbatim të klasifikimeve ndërkombëtare ku INSTAT-i është i aderuar dhe llogaritjen e koeficienteve kryesore për kriminalitetin dhe personat e përfshirë në sistemin e drejtësisë penale. Sigurisht ka më shumë se kaq, por unë vendosa këto në fokus sepse janë shumë të rëndësishëm në periudhën që jetojmë.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, është çështja financiare se sa do të kushtojë gjithë ky aktivitet. Të gjithë fondin financiar Ministria e Financave e ka të përcaktuar në projektbuxhetin afatmesëm dhe besoj se edhe kolegët do të jenë dakord me miratimin e tij.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Faleminderit!

Zonja Resulaj.

**Pranvera Resulaj**- Faleminderit!

Faleminderit, zonja drejtoreshë dhe përfaqësues të INSTAT-i për prezantimin e programit 2022-2026, i cili ishte i mbushur me objektiva të rëndësishme për të rritur efektivitetin e institucionit tuaj!

Një nga elementet që ju përmendët është objektivi shumë i fortë i rritjes së besueshmërisë së publikut tek institucioni juaj.

Këto ditë jemi duke u përballur me rritjen e çmimeve. Do të doja, që në këtë kuadër, të dija nga ju, se pse ju thatë pak më parë se rritja e ndjekjes së faqes suaj krahasuar me vitin e kaluar është rritur me 0,3%? A keni një të dhënë për rritjen e referencës së faqes suaj nga ana e publikut për ta lidhur këtë me besueshmërinë që duhet të ketë? Në një moment të tillë, kur rritja e çmimeve është një element shumë i ndjeshëm për publikun, sa i referohen faqes suaj? Në rritjen e çmimit të shportës a ka ndryshuar protokollin juaj i përditshëm? Pra, si është organizuar institucioni juaj për t'i dhënë një përgjigje dhe informacion të sigurt publikut në lidhje me faktorin e rritjes së çmimeve?

**Eduard Shalsi** – Zoti Agalliu.

**Arbi Agalliu** – Faleminderit!

Unë e shpreh që tani dakordësinë time me këtë projektligj, por do të doja të ngrija një çështje. Në INSTAT-i është në të paktat institucione që ka punuar korrekt dhe ka qenë i pranueshëm. Shqetësim që unë do të doja të evidentoja ka të bëjë me faktin se sa INSTAT-i i qëndron presionit politik. Pra sa INSTAT-i i qëndron deklaratave të forta të politikës për të evidentuar arritje, të cilat në realitet nuk ndodhin?

Duke qenë institucion statistikash, në shumicën dërrmuese të raporteve të tij evidenton dhe tregon se çfarë ka ndodhur, prandaj besueshmëria e këtij institucioni është tepër e brishtë pasi qytetarët, konsumatorët, subjektet, të cilat i përdorin raportet e INSTAT-it arrijnë të kuptojnë dhe dallojnë se çfarë ndodh në realitet dhe çfarë shpreh ai. Kështu që besueshmëria është një element shumë i rëndësishëm i një institucioni që parimisht duhet të jetë asnjë, larg deklaratave politike dhe presioneve politike të opozitës ose maxhorancës. Në këtë kontest në dijeninë time INSTAT-i, nga pikëpamja organizative, e kuadrit ligjor dhe metodologjitë që

përdor, zbaton ato parime, të cilat janë sot për sot në nivelet më të larta, por mënyra, implementimi ose presioni bën që besueshmëria e këtij institucioni shpesh të lëkundet.

Kështu që do të doja të theksoja se nga ana juaj si institucion, si drejtuese, zonja Dhuli, duhet t'i bëni bllok presioneve politike ose grupimeve të interesit për të deformuar të vërtetat që qytetarët, bizneset, shqiptarët i ndiejnë në kurrizin e tyre çdo ditë. Vetëm kështu INSTAT-i do të fitojë reputacionin që të gjithë e duan për të, duke filluar nga studentët për detyrat e kursit, temat e diplomave dhe duke shkuar më tej tek investitorët strategjikë, investuesit e huaj, të cilët duan të dhëna për të investuar në Shqipëri.

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Zonja Dhima, pastaj zonja Koliqi.

Ju lutem, mbani shënim pyetjet dhe nëse edhe nga komentet ka diçka që doni të sqaroni, mund ta bëni.

**Antoneta Dhima-** Faleminderit!

Faleminderit, zonja Dhuli për prezantimin e programit të statistikave zyrtare për periudhën 2022-2026, unë kam disa pyetje!

Ju në fjalën tuaj theksuat vetëm thjeshtë censusin për bujqësinë. A keni parashikuar në vitin 2022 të realizoni censusin për popullsinë dhe banesat? INSTA-i në punë e tij prodhon statistika sociale, demografike, ekonomike, sektoriale, për mjedisin dhe kryen revizionim madhor të llogarive kombëtare, anketa për arsimin e të rriturve, si edhe një sërë anketash të tjera. A i keni ju burimet e mjaftueshme njerëzore për të realizuar të gjitha këto detyrime që përcakton ligji për statistikat?

Në INSTAT janë ngritur dhe funksionojnë disa grupe, siç janë grupi për menaxhimin strategjik, ekipe për menaxhimin e programit dhe një sërë ekipesh të tjera. Ky personel, i cili është pjesë e këtyre grupimeve ose pjesë e këtyre ekipeve a është i trajnuar mjaftueshëm që të realizojë dhe të nxjerrë një produkt shumë të domosdoshëm dhe ky produkt të ketë rezultate konkrete?

**Eduard Shalsi-** Zonja Koliqi.

Përmbledhim pyetjet e para, pastaj nëse ka kolegë të tjerë që duan të bëjnë pyetje, mund t'i bëni pyetje pas zonjës Koliqi.

**Emilja Koliqi** – Faleminderit!

U në do të bëj një pyetje që ka lidhje edhe me pyetjen e zonjës Dhima. Në fund të vitit 2020 u miratua ligji për censin e popullsisë dhe të banesave. Ky është një proces që duhej të kishte filluar që në vitin 2020, por për shkak të pandemisë dhe të tërmetit u shty. Në dijeninë time gjatë vitit 2021 iu është shpërndarë një shkresë të gjitha institucioneve që, sipas ligjit, janë të lidhura më procesin e censit. Unë do të doja të dija se në çfarë stadi është ky proces i censit? Fondet e akorduara nga BE-ja, që kanë qenë rreth 4,8 milionë euro të destinuar për censin, a është arritur të merren edhe të mos tërhiqen nga BE-ja?

Së fundi para se të fillonte procesi i censit nga ana e komuniteteve fetare ka pasur një kërkesë për vërtetësinë e censit për përkatësinë fetare. A është përfshirë kjo pyetje direkt te censusi dhe për ato komunitete fetare që njihen zyrtarisht?

Faleminderit!

**Eduard Shalsi** – Mund të vijoni me përgjigjet zonja Dhuli.

Ndërkohë komisionin do ta drejtoni ju, për shkak të një urgjence që më duhet të komunikoj.

**Elsa Dhuli** – Së pari, falënderoj të gjithë zonjat dhe zotërinjtë deputetë për pyetjet e ngritura!

Unë do të filloj me pyetjen e parë për situatën e çmimeve. INSTAT-i dhe sistemi kombëtar statistikor prodhon statistika zyrtare që do të thotë prodhon statistika të bazuara në metodologji standarde dhe europiane. Megjithatë situata e pandemisë ose situata e çmimeve, të cilat janë të parashikuara na kanë mësuar të marrim edhe disa statistika eksperimentale për t'u përdorur për qëllime të analizave të ndryshme. Në këtë kuptim në lidhje me situatën e çmimeve ne kemi një standard, në datën 8 të fillimit të çdo muaji ne publikojmë zyrtarisht indeksin e çmimeve të konsumit, i cili përmban çmimet e produkteve të shportës e vlerësuar sipas metodologjisë europiane.

Gjatë këtyre ditëve ne kemi bërë një monitorim ditor të çmimeve për të parë dhe pasur luhatjen e tyre, por këto nuk janë të publikueshme, nuk janë statistika zyrtare, sepse nuk duam të konfundojmë përdoruesit me informacionin, por rezultati i këtij monitorimi del në ditën e publikimit të indeksit të çmimeve.

Vëmë re që pesha e çmimeve, ose, të themi, sipas analizave tona dhe vlerësimeve statistikore, pesha e grupit të ushqimeve është rreth 33% në të gjithë peshën totale të mallrave të konsumit, ndërkohë pesha e karburanteve shkon diku të 2%, pesha e energjisë elektrike shkon

diku të 5%. Ka pasur një luhajtje të çmimeve, por e krahasuar kjo me dhjetorin e vitit 2020, luhajtjen më të madhe e kanë pasur çmimet e karburanteve. Megjithatë me datën 8 prill ne do të publikojmë zyrtarisht indeksin e çmimeve të konsumit për muajin mars ku do të jepet edhe reflektimi i kësaj situatë.

Në lidhje me qëndrimin e INSTAT-it ndaj presioneve politike unë besoj se INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, të cilat prodhojnë statistika zyrtare, kanë qenë komplet të pavarura, neutrale. Ne kemi prodhuar dhe publikuar statistika zyrtare për të gjithë përdoruesit pa asnjë lloj dallimi.

INSTAT-i e ka treguar në bazë të statistikave që i ai publikon se është një institucion profesional dhe i pavarur nga çdo lloj presioni ose grup interesi. Ka një bashkëpunim shumë të mirë me të gjitha institucione në vend, me të gjitha grupet e interesit dhe ka qenë i gatshëm për të ofruar aksesin në të dhëna për të gjithë kërkuesit shkencorë ose analistëve. Në këtë drejtim dua të them se pandemia globale Covid-19 e vuri INSTAT-in para disa sfidave ku teknologjia e informacionit bëri që ky institucion të vinte në përdorim sistemin e aksesit online të të dhënave. Gjatë vitit të kaluar ne kemi pasur 9 kërkesa nga brenda dhe jashtë vendit ku kanë qenë 14 përdorues. Kjo ka bërë që ky institucion të jetë pranë përdoruesve pavarësisht situatave të vështira ose sfidave që ka pasur për të përballuar.

Prandaj, mendoj dhe gjykoj, nisur edhe nga treguesit e cilësisë ose anketa e kënaqësisë së përdoruesve, e krijuar që në vitin 2017, se ka pasur çdo vit rritje të besimit të përdoruesve nga të dhënat e publikuesve, si edhe ka pasur rritje të kënaqësisë së përdoruesve me shifrat e publikuara nga institucioni.

Nëse ne themi se kemi një rritje prej 0,1-0,2% për një nivel deri në 5, si shkallë matëse, ne gjykojmë profesionalisht se kemi bërë hapa përpara drejt rritjes së besimit të publikut ndaj statistikave. Megjithatë mbetet shumë për të bërë dhe në 5-vjeçarin e ardhshëm të kemi rritje të cilësisë dhe besim të publikut në statistika.

Në lidhje me pyetjen për censin e popullsisë, në dhjetor të vitit 2020 u miratua ligji për censin e popullsisë dhe banesave. INSTAT-i në vitin 2019 në periudhën ku ra tërmeti përfundoi pilotin e parë dhe për arsye të tërmetit kovidit, zgjedhjeve kombëtare të vitit 2021, duke respektuar rekomandimet e Kombeve të Bashkuara dhe rregulloret europiane, e shtyu censin e popullsisë në tetor të vitit 2022.

Në tetor të këtij viti INSTAT-i do të organizojë censin e popullsisë dhe banesave në mbarë territorin e vendit duke angazhuar afro 8 mijë të punësuar, persona terreni, anketues, kontrollues, supervisorë, ose supervisorë të teknologjisë së informacionit, si dhe do të vërë në dispozicion stafin e tij nga më madhorët në vend dhe që kryhet një herë në 10 vjet sipas të gjitha standardeve.

Në lidhje me pyetjet për burimet e mjaftueshme, në fakt, në programin 5-vjeçar 2022-2026, për shkak të rritjes së aktiviteteve statistikore, ne kemi parashikuar edhe rritje të stafit dhe burimeve financiare. Për vitin 2022-2023 fillimisht kemi kërkuar një rritje stafi prej 13 personash, të cilët do të jenë sport mbështetës për realizimin e këtyre aktiviteteve.

Në lidhje me trajnimin e stafit për trupa, si grupi i menaxhimit strategjik ose bordi drejtues, ose grupe të tjera të ngritura pranë këtij institucioni, një nga institucionet, i cili ka ofruar trajnime të vazhdueshme është ASPA, e cila ka një strukturë trajnimesh të gjithanshme në lidhje me kontrollin financiar dhe menaxhimin e kontrollit financiar dhe publik, i cili është një nga elementet bazë që grupi i menaxhimit strategjik të këtij institucioni ka në fokus, pasi çdo vit ky institucion plotëson pyetësonin e vetëvlerësimit financiar, i cili nga viti në vit ka ardhur në rritje, që kjo tregon se stafi i këtij institucioni një nga fokuset kryesore ka zhvillimin e kapaciteteve jo vetëm profesionale të stafit, por edhe të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Janë trajnuar 146 persona staf nga institucioni, nga ASPA janë organizuar 46 tema ku është trajnuar një numër i konsiderueshëm i stafit të INSTAT-it. Paralelisht ne ndjekim si trajnimet e organizuara brenda në institucion por edhe ato të organizuara nga ASPA.

Në lidhje me stadin e censit, pak më parë theksova se për tri arsye thelbësore, tërmeti, kovidi, zgjedhjet kombëtare si edhe për arsye teknike censi u shty për në tetor të këtij viti. Kjo pati avantazhet dhe disavantazhet e veta. Së pari, pati avantazh sepse i krijoi këtij institucioni dhe i dha kohë për t'iu përgatitur edhe më mirë për realizimin e këtij aktiviteti. Për këtë arsye gjatë vitit 2021 janë organizuar tri parateste në periudhat mars, maj dhe korrik dhe u organizua piloti i dytë në muajt tetor- nëntor të vitit të kaluar, duke i dhënë mundësi pilotit që nëpërmjet këtyre paratesteve dhe testeve gjithëpërfshirës të testonim të gjitha fazat, të cilat do të realizojmë konkretisht në periudhën e terreni të këtij viti, i cili do të zgjatë 6 javë nga 1 tetor deri më 15 nëntor.

Në këtë moment, që ne prezantojmë situatën korente, jemi duke analizuar gjetjet kryesore nga piloti, jemi duke marrë masat si të përballojmë problematikat e ndeshura gjatë pilotit në

mënyrë që të mund të realizojmë një proces të suksesshëm të censit. Censi numëron të gjithë popullsinë rezidente ne territorin e Republikës së Shqipërisë dhe si i tillë, i organizuar një herë në 10 vjet meriton angazhimin dhe përkrahjen e të gjitha institucioneve dhe të banorëve rezidentë të këtij vendi.

Gjithashtu, deri në këto momente ne kemi organizuar takime edhe me kryetarët e 61 bashkive, kemi realizuar 40 takime deri tani, në mënyrë që të kemi edhe një mbështetje gjithëpërfshirëse të pushtetit lokal. Në bazë të ligjit të censit janë krijuar 2 komisione, Komisioni Qendror i Censit, i cili drejtohet nga zëvendëskryeministri, por anëtarë janë të gjithë ministrat e kabinetit qeveritar, si dhe komisionet e censit në nivel bashkie, të cilët drejtohen nga kryetarët e bashkive dhe anëtarë janë punonjës të bashkive apo përfaqësues të Institutit të Statistikave.

Në lidhje me fondet e Bashkimit European, në kushtet e shtyrjes së procesit të censit të popullsisë dhe të banesave të gjitha aktivitetet e parashikuara për censin u rishikuan, u rishikua strategjia, edhe buxheti, por fondi i akorduar nga Komisioni European prej 4,8 milionë jo vetëm që nuk u ndryshua, nuk u tërhoq, por vazhdojnë ende të na mbështesin, duke e mbajtur të qëndrueshëm si fond.

Ajo që ishte sukses i këtij procesi është fakti se të gjitha aktivitetet e censit janë të mbuluara me fonde buxhetore. Kontributi i qeverisë shqiptare ka arritur në masën 54% për këtë cens, kontributi i Komisionit European shkon në masën 25-26%, kemi kontribut nga qeveria suedeze nëpërmjet grantit të ofruar nga SIDA, si dhe qeveria zvicerane nëpërmjet mbështetjes me buxhet të ofruar nga SDS-ja që është Institucioni për Zhvillim i qeverisë zviceriane.

Gjithashtu, kemi pasur mbështetje edhe nga UNFPA-ja si agjenci e UN-it, si dhe kemi gjetur gatishmërinë e të gjitha agjencive të UN-it për mbështetjen e analizave të thelluara bazuar në rezultatet e censit, buxhet, i cili do të akordohet për periudhën 2024-2025, pasi ne të kemi bërë publike gjatë vitit 2023 rezultatet e censit të popullsisë dhe të banesave.

Në lidhje me komunitetet fetare, gjatë periudhës së organizimit të pilotit përpara, por edhe gjatë pilotit ne kemi organizuar në të nënta bashkitë, ku ishte i fokusuar organizimi i pilotit, takime me 9 grupe interesi. Ndër grupet më aktive të interesit kanë qenë komunitetet fetare, të cilat kanë marrë pjesë në të gjitha këto takime, pasi krahas pjesëmarrjes së tyre në grupet e interesit kemi kryer edhe takime të ngushta me përfaqësues të komuniteteve fetare. Në pyetësinë e censit do të ketë pyetje edhe mbi “bashkësinë fetare”, të cilat konsiderohen si pyetje sensitive, ku në përgjigje të kësaj pyetjeje është edhe e drejta për të mos u përgjigjur, por pa u penalizuar.



Po ashtu, është edhe pyetja “mbi identitetin e lirë etnik të popullsisë rezidente” apo pyetja “mbi gjuhën”. Të tria pyetjet janë konsideruar sensitive, kanë në përmbajtje të drejtën për të mos u përgjigjur, si dhe nuk penalizohen, kjo është e referuar në nenin 22 të ligjit “Për censin e popullsisë dhe të banesave”.

Struktura dhe përmbajtja e bashkësive fetare është në bazë të strukturës që ekziston në Shqipëri, e dakordësuar kjo edhe me komunitetet fetare.

Nëse mund të kem lënë ndonjë pyetje pa kthyer përgjigje jam e gatshme për të vazhduar.

**Sorina Koti** – Faleminderit, zonja Dhuli.

Zonja Zake, e ka fjalën për pyetje.

Më pas zoti Leskaj.

**Enslemvera Zake** – Drejtoreshë, faleminderit për prezantimin!

Gjatë fjalës suaj thatë që një nga fushat e statistikave që ju përpunoni dhe publikoni janë edhe statistikat sektoriale, ku bëjnë pjesë bujqësia, peshkimi dhe pyjet. Sipas informacionit që ju keni censusi në bujqësi bëhet 1 herë në 10 vjet dhe i bie që ky census të bëhet në vitin 2024. Duke pasur parasysh situatën në të cilën ndodhet Shqipëria sot, ku bujqësia është një ndër fushat më sensitive, a mos ndoshta këta indikatorët që ne do të marrim nga censusi i vitit 2024 do të jenë të vonuar në mënyrë që politikat dhe programet qeveritare ta marrin këtë informacion nga censusi në bujqësi dhe mos vallë këta indikatorë do të ndikojnë në politikat e zhvillimit që qeveria do të marrë në sektorin e bujqësisë?

Faleminderit!

**Sorina Koti** – Zoti Leskaj.

**Bujar Leskaj** – Së pari, për të shmangur çdo keqkuptim që në krye të herës po shfaq respektin tim për standardet e larta profesionale të INSTAT-it, drejtueses së tij, si dhe të gjithë bashkëpunëtorëve, duke ju uruar suksese!

Mendimi im është që ju gjatë këtyre viteve keni vazhduar me fillesat e mira të viteve ‘91-’92, që u ravijëzuan qartë edhe në vitet ‘95-’96, për të vazhduar në vijimësi, megjithatë puna juaj personalisht si drejtuese është e nivelit të lartë profesional.

Pyetja ime e parë ka të bëjë me një shqetësim që e kanë të gjithë shqiptarët. Të dhënat tuaja që jepni në vjetarët tuaj statistikorë, janë të plota dhe të dhëna të larmishme. Si mendoni ju, përse qeveria jonë nuk e përcakton minimumin zyrtar jetik?

Në rast se e konsideroni që pyetja ime është me konotacion politik, për hir të vërtetës e tillë është, edhe po të mos përgjigjeni nuk mërzitem, por doja të isha i qetë me ndërgjegjen time.

E dyta, më vjen mirë që programin e mbyllni me një analizë tuajën, sepse institucionet serioze atë bëjnë dhe përpiqen deri në fund të ecin dhe ta ballafaqojnë veten në punën e tyre me këtë analizë me të tashmen dhe të ardhmen, me dobësitë, kërcënimet, oportunitetet dhe arritjet.

Ju flisni me të drejtë sa u takon pikave të dobëta për auditin statistikor. Si mendoni ta thelloni dhe ta konturoni qartë, në rast se ju e keni nisur në ndonjë institucion të veçantë, këtë audit statistikor që ju t'ju jepni besueshmëri atyre institucioneve që i përcjellin të dhënat te ju?

Ne jemi të gjithë të ndërgjegjshëm që nuk është ai seriozitet, profesionalizëm dhe ndershmëri në të gjitha institucionet tona apo te sektorët përkatës të statistikave, sepse ka edhe institucione të caktuara, të cilat për fat të keq konsiderohen nga më të parëndësishmit në një kohë kur duhet të jetë e kundërta për sa i takon profesionalizmit, pavarësisë e të tjera me radhë. Nuk po kaloj te çështja tjetër për të mos e politizuar. Të urojmë Zotin që edhe tek këto të dhëna statistikore që ju paraqitet të mos jenë futur këta patronazhistët e famshëm që shfaqen në të gjitha format.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Është mendimi im, sepse thashë uroj Zotin.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kush Ismet?

Pyet shokët e tu që kanë vajtur atje, pyet Kryeministrin që vajti me 5 ministra në një panair të rëndomtë turizmi në Abu Dhabi.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Eventi është panair i rëndomtë turizmi dhe nuk mund të shkonin 5 ministra dhe Kryeministri.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Vlora është më keq se Durrësi, sepse grabitja është më e madhe.

I nderuar zoti deputet, mos më ndërhyjni më.

Zonja drejtuese, ju lutem...

**Sorina Koti** – Vazhdoni zoti Leskaj.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Unë nuk e politizoj, por po e ripërsëris respektin dhe vlerësimin tim. Ne do të ecim përpara si shqiptarë nëse mbi gjysma e institucioneve tona të jenë si INSAT-i, por për fat të keq në këtë kohë numërohen me gishtat e dorës.

Ju uroj suksese drejtuesve të INSTAT-it!

Pyetjet e tjera nuk po i bëj.

**Sorina Koti** – Faleminderit, zoti Leskaj!

Para se t'ia jap fjalën zonjës Dhuli, do të doja të bëja edhe unë disa komente dhe pyetje.

Në radhë të parë ju përgëzoj për punën dhe për rritjen e besueshmërisë dhe të klikimeve që ka pasur INSTAT-i nga viti në vit. Në fakt, ky është një nga problematikat më të mëdha që ka pasur ky institucion. Unë vërtet sot jam deputete, por si profesion jam ekonomiste dhe pedagoge, kështu që i kam përdorur shumë linkun e institucionit tuaj për të marrë të dhëna statistikore për punën time. Do të doja që ju të bënit më shumë, siç e tha edhe zoti Leksaj pak më parë, një verifikim të të dhënave që i merrni nga burimet e tjera, për vërtetësinë e tyre dhe jo të merren shabllon ashtu siç jua sjellin disa institucione institucionit tuaj pa i verifikuar apo pa i përpunuar më parë.

Në bazë të të dhënave që ne përdorim nga INSTAT-i, një pjesë të tyre i përdor qeveria për hartimin e politikave të saj, i përdorim edhe ne si opozitë për të bërë pjesën tonë politike, por në radhë të parë i përdorin të gjithë qytetarët e Shqipërisë, kështu që ato duhet të jenë sa më të vërteta.

Çfarë problematikash keni pasur te programi IPARD 2017-2021? Si i keni reflektuar problematikat e hasura te programi i ri që po paraqisni sot?

Sa i takon censusit të popullsisë dhe të bujqësisë, është e vërtetë ajo që ju thatë që do ta filloni në muajin tetor. Si do ta realizoni ju këtë në mënyrë që të keni rezultate më të kënaqshme dhe më reale, sepse gjatë censusit të parë ka pasur probleme me regjistrimin e popullsisë, pasi shumë banorë nuk gjendeshin në banesat e tyre? Çfarë metodologjie do të ndiqni që këtë radhë të kemi një regjistrim real të popullsisë dhe të banesave të tyre, eficiencën e të dhënave dhe vërtetësinë e tyre? Kur është bërë censusi i parë, për fat të keq, pjesa më e madhe e formularëve janë mbushur me laps dhe jo me stilolaps dhe kjo ka lënë hapësirë për t'i ndryshuar të dhënat dhe për të ndërhyrë te censi.

Meqenëse do të bëhet regjistrimi i banesave, ndoshta ju mund të keni edhe një rakordim me regjistrin e kadastrës për regjistrimin e banesave dhe verifikimin e pasurive të banorëve të

Shqipërisë, pasi një ndër problemet që ne kemi ka të bëjë me regjistrin e kadastrës dhe hipotekimin e tyre, kështu që në këtë rast mund të ndihmoni edhe për këtë pjesë.

Në lidhje me cilësinë e jetës së qytetarëve, ndoshta do të ishte më mirë që të matni mirëqenien e qytetarëve. Ne themi gjithmonë që kemi një rritje të GDP-së, por sa e prekshme është kjo te qytetarët? A reflektohet kjo rritje e GDP-së te mirëqenia e secilit prej nesh? A rriten të ardhurat për frymë dhe mirëqenia e tyre?

Me këtë rast, meqenëse do të kemi edhe cilësinë e jetës të matshme nga ju ndoshta mund t'i ndihmoni përsëri institucionet e tjera të varësisë në lidhje me familjet e varfra, familjet me ndihmë ekonomike, numrin e saktë të tyre, cilësinë e vërtetë të jetesës së tyre, pasi kjo mund të ndihmojë në hartimin e politikave për mbrojtjen sociale. Ndihma ekonomike është në vlera jashtëzakonisht të ulëta dhe ndoshta minimumi jetik i vendosur si standard, gjë, e cila duhet të jetë me ligj, do ta ndihmonte këtë shtresë në nevojë.

Sa i takon censit të bujqësisë, do të kisha të njëjtin rekomandim si zonja Zake, që të bëhet më herët, pasi problemi që kanë fermerët me tokat e tyre për mosregjistrimin e tokave bujqësore i pamundëson ata të marrin financime nga AZHBR-ja dhe nga bankat. Ndoshta viti 2024 do të jetë një vit i vonë për ta ndihmuar këtë sektor kaq jetik, duke ditur që kriza ekonomike vazhdon të thellohet, fermerët duhet të subvencionohen, por mungesa e regjistrimit të bujqësisë i ka frenuar ata për të marrë zhvillimin e duhur.

Ju falënderoj për përgjigjet që u keni dhënë kolegëve për pyetjet dhe diskutimet që ata ju kanë bërë deri tani!

Zonja Dhuli, fjala për ju.

**Elsa Dhuli** – Faleminderit për pyetjet!

Në lidhje me censin e bujqësisë, këtu mund t'u kthej përgjigje të dyja pyetjeve të ngritura për të. Censi për bujqësinë ishte i parashikuar të kryhej në vitin 2022, por për shkak të shtyrjes së censit të popullsisë jemi të detyruar ta shtyjmë edhe censin për bujqësinë në vitin 2024. Kjo për faktin se censi i popullsisë përmban një modul me pyetje mbi aktivitetin në bujqësisë, që do të thotë se duke u bazuar në rezultatet që do të mblidhen gjatë censit të popullsisë do të krijohet *database* për organizimin e censit të bujqësisë.

Nisur nga fakti që censi i popullsisë do të kryhet duke zbatuar teknologjinë, pra grumbullimi i të dhënave do të bëhet me tabletë, të cilat do të përdoren edhe për censin e bujqësisë, rezultatet e para do të jenë gati në fillim të vitit 2023.

Gjatë vitit 2023 do të kryhen të gjitha proceset testim dhe pilot për censin e bujqësisë dhe në vitin 2024 do të organizohet censi. Kjo është një procedurë, sepse ne jemi duke ndjekur të gjitha standardet dhe metodologjinë europiane dhe për këto arsye është e pamundur që ne të mundeshim ta organizonim censin për bujqësinë qoftë edhe një vit më parë. Megjithatë, ne vazhdojmë të kryejmë vrojtime në sektorë të veçantë të bujqësisë, publikojmë shifra mbi bujqësinë, pra bëjmë maksimumin tonë referuar të gjitha statistikave të bujqësisë dhe blegtorisë në bazë të statistikave zyrtare.

Censi është një nga çështjet më të rëndësishme, por në kushtet dhe situatën ku jemi, si rezultat i shtyrjes së censit për popullsinë, jemi të detyruar ta shtyjmë edhe censin e bujqësisë.

Në lidhje me pyetjen mbi minimumin jetik më duhet t'ju them që nuk është Instituti i Statistikave ai që llogarit minimumin jetik, por janë institucione të tjera. Ne kemi qenë të gatshëm dhe u kemi ofruar të gjithë informacionin statistikor që na është kërkuar për matjen e minimumit jetik, por nuk është se atë e përcakton INSTAT-i. Në këtë drejtim ajo çfarë ka bërë institucioni ynë është fakti që prej 4 vjetësh ne organizojmë anketën e matjes së nivelit të jetesës, e cila është një burim informacioni që mund t'u shërbejë institucioneve të tjera për matjen e minimumit jetik. Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë, siç kemi bashkëpunuar deri tani, në funksion të këtij procesi, por nuk është në...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kemi bashkëpunuar dhe kemi dhënë informacione. Anketa e matjes së nivelit të jetesës, e cila është me standarde europiane është një burim informacioni.

*(Zoti Leskaj ndërhyr pa mikrofon.)*

Nuk janë vetëm të dhënat e INSTAT-it që nevojiten.

*(Zoti Leskaj ndërhyr pa mikrofon.)*

Në lidhje me auditin statistikor.

Në fakt, procesi i auditit statistikor është proces i kontrollit, i monitorimit dhe i ndjekjes së cilësisë të të gjitha proceseve statistikore të kryera nga vetë Instituti i Statistikave apo edhe nga Agjencitë Statistikore.

INSTAT-i e ka përfshirë edhe në ligjin për statistikat të vitit 2018 dhe ka filluar procesin e vetëvlerësimit të mënyrës se si ky institucion zbaton parimet e cilësisë në të gjitha hapat e proceseve statistikore. Përveç kësaj ne kemi filluar edhe trajnimin e Agjencive Statistikore se si

këto agjenci të vetëvlerësojnë veten e tyre dhe të monitorohen nga Instituti i Statistikave si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor.

Kjo ka bërë që në ato aktivitete statistikore ku është kryer ky proces ne të parashikojmë masa për përmirësim dhe për zbatim e tyre. Kjo na ka nxitur për të përmirësuar dhe rritur cilësinë e produkteve statistikore, prandaj edhe procesi i auditit statistikor është në vetvete monitorim i kryerjes, sipas standardeve dhe parimeve të cilësisë së proceseve statistikore të një aktiviteti.

Në lidhje me censin e bujqësisë iu përgjigja pyetjes.

Sa u takon verifikimeve nga institucionet e tjera, Instituti i Statistikave punon me afro 46 institucione nga të cilat grumbullon informacion në mënyrë të agreguar dhe disagreguar, pra në nivel rekordi, bën të gjitha kontrollet e mundshme të cilësisë të marrjes së këtyre burimeve nga burimet administrative në mënyrë që të kemi një përmirësim cilësor në statistikat zyrtare që ne prodhojmë. Por për pjesën e dokumentimit apo e monitorimit nga ana e institucionit se sa këto institucione ndjekin standardet europiane, duhet të kuptojmë që në Shqipëri janë vetëm 3 institucione që prodhojnë statistika zyrtare, të cilat kanë detyrimin të ndjekin dhe të zbatojnë të gjitha metodologjitë dhe standardet europiane. Në këtë drejtim kryesori është Instituti i Statistikave, që prodhon statistikat zyrtare, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në lidhje me problematikat e reflektuara në PSZ-në e vitit të kaluar, në fakt, jemi munduar t'i analizojmë si problematika dhe gjetje kryesore disa elemente siç janë: të jemi më pranë përdoruesve, të rrisim procesin e komunikimit të statistikave zyrtare te përdoruesit në mënyrë që ata t'i kuptojnë dhe t'i interpretojnë në mënyrë të drejtë dhe të saktë statistikat zyrtare të publikuara nga Sistemi Kombëtar Statistikor.

Kemi identifikuar që duhet të punojmë akoma më shumë për përmirësimin e metodologjive statistikore në mënyrë që të zbatojmë në një nivel më të lartë përputhshmërie rregulloret dhe standardet europiane, të shkurtojmë afatet kohore të publikimit të treguesve kryesorë statistikorë në mënyrë që të vijmë në kohë reale dhe sa më shpejtë pranë përdoruesve, të reduktojmë koston e vrojtimit statistikore, duke përdorur në një mënyrë dhe masë të konsiderueshme burimet administrative, gjë, e cila do të na çojë në uljen e koston dhe rritjen e efikasitetit të produkteve statistikore.

Këto kanë qenë problematikat kryesore të cilat ne jemi fokusuar akoma edhe më shumë në programin e ardhshëm.

Gjithashtu, për të rritur nivelin e përputhshmërisë dhe për të respektuar standardet europiane, duhet të rrisim nivelin e transmetimit të të dhënave statistikore në *database*-n europiane të statistikave, ku ne kemi marrë një angazhim, që nga 46 produkte statistikore të transmetuara deri tani, të shkojmë në 110 produkte, edhe pse në nivel informacioni statistikor të detajuar çdo vit. Ne kemi rritje të konsiderueshme nga vlerësimet e Eurostat-it. Shqipëria ka një vlerësim pozitiv në Eurostat në transmetimin e produkteve statistikore dhe përsëri synojmë të kemi një rritje të konsiderueshme.

Këto kanë qenë ndoshta edhe problemet kryesore, por synojmë të kemi rritje dhe përmirësim të konsiderueshëm në programin e ardhshëm.

**Sorina Koti** - Të falënderoj, zonja Dhuli, për prezantimin!

Ftoj kolegët ta hedhim në votim në parim projektligjin “Për miratimin e programit të statistikave zyrtare 2022-2026”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju faleminderit, zonja Dhuli!

Faleminderit pjesëmarrësve të institucionit të statistikave: zonjës Dhuli; zotit Dema; zonjës Mitre dhe zonjës Sevrani!

Faleminderit!

**Elsa Dhuli** – Faleminderit edhe juve për besimin!

**Sekretare e komisionit**  
**Enslemvera Zake**

**Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretar Administrariv**  
**Elvi Prifti**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.3.2022, ora 10:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Sorina Koti – zëvendëskryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Shqyrtimi në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjeshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66”.

#### **Marrin pjesë:**

Eduard Shalsi, Sorina Koti, Enslemvera Zake, Arbi Agalliu, Emilja Koliqi, Edmond Spaho, Benet Beci, Erion Braçe, Anila Denaj, Bujar Leskaj, Alban Xhelili, Vullnet Sinaj, Pranvera Resulaj, Antoneta Dhima dhe Dashamir Shehi.

#### **Mungojnë:**

Blerina Gjylameti, Alfred Rushaj, Jorida Tabaku, Agron Shehaj dhe Shpresa Marnoj.

#### **Të ftuar:**

Meri Kumbe - Zëvendësministre e Kulturës

Anila Muka - Drejtore e Drejtorisë së Integritimit në Ministrinë e Kulturës

Gentian Opre - Drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Vilma Causholli - Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Analizës Buxhetore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë



**Sorina Koti** - Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, te shqyrtimi, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66”.

Ftojme përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, përfaqësuar nga zonja Meri Kumbe, zëvendësministre e Kulturës, zonja Anila Muka, drejtore e Drejtorisë së Integritit. Nga Ministria e Financave kemi të ftuar zotin Gentian Opre, drejtor i Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor, nuk ka ardhur, dhe zonjën Vilma Causholli, përgjegjëse Sektori në Sektorin e Analizës Buxhetore.

Faleminderit, zonja Kumbe!

Zonja Kumbe, mund bëni një prezantim të projektligjit, ju lutem!

**Meri Kumbe** – Përshëndetje!

Faleminderit!

Ky projektligj mbështetet në nenin 81, pika 1, dhe nenin 100, të Kushtetutës dhe është në përputhje me ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Këshilli i Ministrave në datën 2 shkurt 2022 ka miratuar projektvendimin për propozimin e këtij projektligji për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje me programin e Ministrisë së Kulturës për përforcimin e potencialit të rrugëve kulturore.

Shumë shkurtimisht më lejoni të bëj një prezantim të këtij programi.

Programi “Rrugët kulturore” është një program i Komisionit Europian dhe certifikon rrugët kulturore në të gjithë Europën, por edhe jashtë territorit, si të Bashkimit Europian, ashtu edhe të Europës gjeografike, duke zgjedhur tematika të caktuara. Për shembull, tematikat ku Shqipëria aktualisht gjendet e evidentuar, janë rrugët: “Pema e ullirit”, “Fenikasis”, “Atriumi”, “Aeneas”. Gjithashtu, një sërë nismash të reja janë ndërmarrë për krijimin e rrugëve “Shkrimtaret gra”, “Rruga Europiane e Përrallave”, “Rruga Historike e Kafeneve”, “Rruga e Çokollatës” e të tjera.

Për të aderuar në këtë program Shqipërisë i duhet të paguajë një biletë hyrëse në vlerën 5300 euro në vit, çka do t’u mundësonte më pas të gjitha grupeve të interesit të aksesonin dhe të aplikonin në programe të caktuara të shpallura për rrugët kulturore, sikurse janë: Europa për qytetarët; *Creative Europe*, në sektorin e rrugëve kulturore; fonde të caktuara IPA e të tjera.

Grupet e interesit, të cilat do të kishin një avantazh direkt nga ky program, janë pushteti vendor, bizneset lokale dhe operatorët turistikë, që operojnë në zona të caktuara të vendit.

Faleminderit!

**Sorina Koti** - Faleminderit, zonja Kumbe!

Fjala i jepet zotit Sinaj, si relator i çështjes.

**Vullnet Sinaj** – Faleminderit, nënkryetare!

Nga vetë titulli i këtij projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar për rrugët kulturore, miratuar me rezolutën CM/RES (2013) 66”, kuptohet që synimi është aderimi i Shqipërisë në këtë marrëveshje.

Ne, si Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, e shqyrtojmë, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, këtë projektligj bazuar në nenet 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit. Ky projektligj është në përputhje me nenin 81, pika 1, dhe nenin 100, të Kushtetutës dhe me nenin 18 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

Unë jam zgjeruar pak për të kuptuar pse kjo marrëveshje quhet “e pjesshme e zgjeruar” dhe shkurtimisht më poshtë quhet “EPA”. Është një term i përdorur brenda Këshillit të Europës dhe i referohet një aktiviteti, i cili nuk përfshin të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës, por njëkohësisht përfshin dhe shtete joanëtare të tij. Kjo marrëveshje rrjedh nga një program i Këshillit të Europës, i quajtur “Rrugët kulturore”, lançuar për herë të parë në vitin 1987, si një udhëtim në kohë dhe në hapësirë, me qëllimin që trashëgimia dhe kultura e vendeve të ndryshme dhe të largëta në distancë, të mund të përmbliidhen dhe të ndërthuren me trashëgiminë e përbashkët europiane. Rrugët kulturore janë itinerare ose një seri itinerarësh kulturore, sociale, historike, ndërkombëtare dhe të shtrira në shtete të ndryshme. Të tilla janë: një rrugë antike mesjetare e njohur historikisht me vlerat e trashëgimisë kulturore, që ka lënë gjurmë të thella në ekonomi, transport, shkëmbime përgjatë shekujve; një bashkësi vlerash kulturore, historike, urbanistike, tradicionale, biodiversitet; një figurë historike apo legjendare me rëndësi të madhe, e cila bën bashkë popuj të ndryshëm në shtete gjeografikisht të shpërndara. Pra, një rrugë kulturore nuk është domosdoshmërisht një shteg fizik për t’u kaluar, por mund të përbëhet edhe nga aktorë kulturorë të tjerë.

Marrëveshja, që propozohet për aderimin me këtë projektligj, ka për qëllim të kontribuojë në promovimin e identitetit dhe të qytetarisë europiane nëpërmjet njohjes së trashëgimisë së

përbashkët të Europës, zhvillimit të lidhjeve kulturore dhe dialogut brenda Europës, por edhe me vende e rajone të tjera.

Nëpërmjet zhvillimit të rrugëve kulturore, kjo marrëveshje synon të krijojë një hapësirë të përbashkët kulturore, që synon të nxisë ndërgjegjësimin për trashëgiminë, arsimin, rrjetëzimin, turizmin kulturor, ndërkufitar, cilësor, të qëndrueshëm dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Miratimi i këtij projektligji është në përputhje me programin e Ministrisë së Kulturës për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve kulturore me vendet e tjera.

Aderimi i Shqipërisë në këtë marrëveshje do të krijojë mundësinë që vendi ynë, duke u mbështetur në ekspertizën e Institutit European të Rrugëve Kulturore, i cili ndodhet në Luksemburg, ku është edhe selia e EPA-s, të përfitojë këshillime dhe asistencë për zhvillimin, zbatimin, vlerësimin dhe promovimin e rrugëve kulturore, ku përfshihen: përgatitja dhe zbatimi i strategjive për financim dhe promovim; zhvillimi i një oferte të qëndrueshme turistike të bazuar në rrugët kulturore, duke kontribuar kështu në mirëqenien ekonomike; ekspertizë në ngritjen e rrjeteve dhe të organizatave të projektit, si dhe zhvillimi i marrëveshjeve të përbashkëta, kërkime për sfondin historik të rrugëve, zhvillimi i kulturës, përmbajtja edukative dhe aktivitete të rrugëve kulturore.

Kjo organizatë ka edhe një strukturë të vetën, që përbëhet nga bordi, i cili jep edhe certifikatën e rrugëve kulturore, bën edhe programin, ka byronë, ka një komision statusor, i cili ka detyrat e tij, kryesisht, lidhur me buxhetin, ka një sekretar ekskluziv, i cili zgjidhet nga sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Komiteti Statusor do të përcaktojë çdo vit totalin e kontributeve të detyrueshme të anëtarëve dhe shkallën e kontributeve sipas cilësisë. Ky total do të ndahet ndërmjet shteteve pjesëmarrëse, që si rregull duhet të jetë në përputhje me kriteret për përcaktimin e shkallës së kontributeve në buxhetin e përgjithshëm të Këshillit të Europës. EPA mund të marrë kontribute nga Bashkimi European dhe kontribute vullnetare.

Tarifa vjetore e anëtarësimit për vendin tonë do të jetë rreth 5300 euro. Kjo shumë është përcaktuar për periudhën 2022-2024 dhe do të përballohet nga Ministria e Kulturës në buxhetin tavanor të Ministrisë së Kulturës. Shpenzime të tjera janë parashikuar, gjithashtu, në buxhetin e Ministrisë së Kulturës.

Kështu që, për vlerat që ky projektligj ka në zhvillimin e turizmit në vendin tonë, ju ftoj ta miratojmë së bashku.

Faleminderit!

**Sorina Koti** - Faleminderit, zoti Sinaj!

A ka pyetje, komente?

Zonja Koliqi, fjala është për ju.

**Emilja Koliqi** – Faleminderit për prezantimin!

Unë kisha disa pyetje në lidhje me rrugët kulturore. Nga kush do të përcaktohen këto rrugë kulturore? Gjithashtu, duke qenë se “operatori i rrugës kulturore” është një term që përdoret, cili do të jetë konkretisht ky operator? Pyetja tjetër është: certifikimi, që do të bëhet, do të jetë i përkohshëm apo kjo rrugë kulturore do të jetë në vazhdimësi?

**Sorina Koti** – Zonja Kumbe, fjala është për ju.

**Meri Kumbe** – Atëherë, rrugët kulturore janë të përcaktuara nga Këshilli i Europës, pjesa e ekzistuesve e tyre aktualisht është *online*, sigurisht ato çdo vit shtohen në mbledhjet rutinë që bën EPA.

Pasi ne të kemi aderuar, vetë Ministria e Kulturës do të shohë të gjitha rrugët aktualisht ekzistuese në faqen e Europës, madje po të hynim edhe tani bashkërisht, do të shihnim që në të gjitha rrugët ekzistuese, vetë Këshilli i Europës i ka përcaktuar shtetet në bazë të një kërkimi që kanë bërë, duke parë potencialin e zhvillimit për secilën rrugë. Ne aktualisht nuk aderojmë në këtë program, por do të shihni që te 4 rrugë Shqipëria përmendet si vend potencial që preket nga këto rrugë. Pasi përcaktohen rrugët, fillimisht nga Këshilli i Europës, por edhe aty ku ne do të kemi sugjerime për të evidentuar rrugë të shtuara, sikurse është rasti i rrugëve të reja: “Shkrimtaret gra”; “Rruga e Çokollatave”, ka disa rrugë të tjera që lidhen me rituale fetare, kryesisht me festat e Pashkëve, që prekin Ballkanin kryesisht, do t’i evoluojmë rast pas rasti.

Sa i përket territorit tonë, nga momenti që ne evidentojmë rrugën, ajo pastaj është një ftesë për të gjithë pushtetin vendor dhe operatorët turistikë për të përcaktuar ku mund të shkonte ekzaktësisht kjo rrugë, pra le të themi një rrugë virtuale që ndërtohet në hartë, dhe si mund të ngremë projekte specifike për promovimin e secilës prej tyre. Ashtu sikurse e përmendi edhe relatori, kemi të bëjmë me rrugë fizike, por edhe me rrugë virtuale, të cilat përkthehen në rrugë fizike dhe një ndër këto raste janë legjendat. Vendi ynë ka një trashëgimi shumë të pasur të trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe legjendat janë të shtrira, absolutisht, në të gjithë vendin. Sigurisht, mund t’i grupojmë me tematika, pra do të jetë një punë në proces në nivel ekspertësh për të përcaktuar si do t’i definojmë ato rrugë konkretisht në territorin tonë.

Faleminderit!

**Emilja Koliqi** – A mund ta di ku shtrihet “Rruga e Çokollatave”? Përfshihet edhe Shqipëria në këtë rrugë?

**Meri Kumbe** – Një rrugë shumë interesante është “Rruga e Kafenesë” ose e “Kafesë”. Ne nuk jemi vend prodhues i kafesë, siç mund të jetë Brazili, por ne jemi një vend që kemi shumë kafene, kështu që mund të aderojmë për të përthithur turistë, të cilët janë të fokusuar drejt kësaj tematike.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Sorina Koti** – Faleminderit, zonja Kumbe!

Të nderuar kolegë, ka pyetje apo komente të tjera?

Kalojmë në votimin në parim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Falënderojmë përfaqësuesit e ministrive dhe shpresojmë që rrugët kulturore të shtohen sa më shumë në rastin e Shqipërisë.

Faleminderit!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

Mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Sekretare e komisionit**  
**Enslemvera Zake**

**Përgjegjësja e Shërbimit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Sekretar Administrariv**  
**Elvi Prifti**